



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2020:169290

Datë: 27.03.2024

Numri i dokumentit: 05512050

**P.nr.108/21**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN** – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Arlind Sharani, me zyrtarin ligjor Amar Hoxha, në lëndën penale kundër të akuzuarit K.K., nga Prizren, për shkak të veprës penale punimet të kundërligjshme, nga neni 360 par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren – Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP/II.nr.2111-12/20, të datës 29.01.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 26.03.2024, në prezencën e Prokurorit të shtetit Musli Gashi, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij av. V.H., në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 27.03.2024 e përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari:

**K.K.**, nga i ati ....., e ëma ....., e gjinisë ....., i lindur me .....në Prizren, ku edhe tani banon në rrugën “.....” p.nr., i martuar-baba i 3 fëmijëve, bujk, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës, me numër të personal ....., dhe numër të letërnjoftimit ID .....

**Ë S H T Ë F A J T O R**

Nga viti 2018 e deri me dt.17.09.2020, në fshatin turistik Prevall, i pandehuri K.K., në cilësi të poseduesit të lejes dhe investitorit, vepron në kundërshtim me kushtet e Lejes Ndërtimore, me Nr. K.III-21/2018, dt.01.08.2018, të lëshuar nga MMPH, për “objekt banimiturizëm fshatar P+1, në parcelën kadastrale nr.141-4, ZK.Gornja Sellë, ashtu që gjatë realizimit të punimeve, ka lejuar tejkalimin e lejes ndërtimore, më q’rast, janë realizuar punime ndërtimore në kundërshtim me projektin kryesor të aprovuar, ku është realizuar pllaka e betonit në themele e cila lidh objektin me murin mbrojtës, hapjet në fasadën veri-lindore, muri i përdhësës i projektuar nga betoni është realizuar me blloka betoni, po ashtu është realizuar ngritja e mureve në lartësi 1.20m, si dhe murit të kallkanit, gjithashtu i pandehuri-investitori, nuk ka respektuar Vendimin nr.4792-2/18, dt.19.12.2018, vendimin nr.2119-2/20 dt.10.04.2020, për ndalimin e punimeve dhe vendimin nr.3003/20, dt.14.07.2020 për rrënim.

**Me këto veprime kryen veprën penale punimet ndërtimore të kundërligjshme, nga neni 360 paragrafi 1, të KPRK-së.**

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 38, 40, 42, 43, 44, 69, 70, 79 par.1, dhe nenit 360 par. 1 të KPRK-së, dhe nenin 364 të KPPRK-së, të akuzuarin e:

## **G J Y K O N:**

**ME DËNIM ME BURGIM** në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim me burgim konform nenit 44 të KPRK-së, me pëlqimin dhe kërkesën e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij zëvendësohet **ME DËNIM ME GJOBË** në shumën prej 1200€ (njëmijë e dyqind euro), të cilin dënim i akuzuari duhet ta paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi me gjobë nuk ekzekutohet në afatin ligjor i njëjti do të zëvendësohet me 60 (gjashtëdhjetë) ditë dënim burgu duke llogaritur për 20 € një ditë burg.

Detyrohet i akuzuari K.K., që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë për shpenzimet e paushallit gjyqësorë në shumën prej 20€ (njëzet euro), ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20€ (njëzet euro), të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në Prishtinë, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

## **A r s y e t i m**

### *1. Ecuria e procedurës penale*

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/II.nr.2111-12/20, të datës 29.01.2021, kundër të akuzuarit K.K., nga Prizreni, për shkak të veprës penale punimet të kundërligjshme, nga neni 360 par.1 të KPRK-së.

I akuzuari K.K., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se: pas leximit të aktakuzës e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, është penduar për këtë veprim, se është mbajtës i familjes, në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të këtilla, duke shtuar se veprimin e ka kryer për shkak të nevojës së detyrueshme për të ngritur murin për shkak të sigurisë pasi që ka mundur edhe të shembet dheu afër shtëpisë.

Mbrojtësi i të pandehurit av. V.H., nuk e ka kundërshtuar pranimin e fajësisë të mbrojturit të tij, duke shtuar se për shkaqe të rrethanave objektive të cilat e kanë detyruar që të ndërmarrë veprimin i cili rezultoi i kundërligjshëm, prandaj ka kërkuar nga gjykata që ta aprovojë një pranim të tillë dhe të ketë parasysh të gjitha rrethanat të cilat i deklaroi vet i mbrojturi im si rrethana lehtësuese, e veçanërisht si rrethanë posaçërisht lehtësuese pranimin e fajësisë që në shqyrtim fillestar.

Prokurori i shtetit Musli Gashi, duke dhënë mendim rreth pranimit të fajësisë ka deklaruar se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi që e njëjta ka mbështetje të plotë në provat dhe materialet të cilat i përmban aktakuza dhe është bërë në pajtim të plotë me dispozita ligjore të KPPRK-së.

## 2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marr aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 242 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 248 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

## 3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

- se i akuzuari K.K., me dashje ka kryer veprën penale punimet të kundërligjshme, nga neni 360 par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të Aktgjykimit.

## 4. Elementet e veprës penale

Në nenin 360 par.1 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale punimet e kundërligjshme e kryen: “Personi përgjegjës i cili me rastin e projektimit, mbikëqyrjes apo kryerjes së ndonjë ndërtimi apo të punëve ndërtimore ose përfundimit të punëve ndërtimore, vepron në shkelje të ligjit apo në kundërshtim me standardet profesionale përgjithësisht të pranuar ose në kundërshtim me kushtet e lejes së ndërtimit ose certifikatës së përdorimit, kryerësi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet”.

## 5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues

Andaj, duke u bazuar edhe në gjendjen e vërtetuar faktike, gjyqtari i vetëm gjykues duke u bazuar në dispozitat ligjore të lartpërmendura, e ka shpallur fajtor të akuzuarin K.K., për shkak të veprës penale punimet të kundërligjshme, nga neni 360 par.1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj veprë penale dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

## 6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: është mbajtës i familjes baba i 3 fëmijëve, pendimin e tij, në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt. Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese për të akuzuarin gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e tij në shqyrtimin fillestar për veprën penale për të cilën ngarkohet. Ndërsa, si rrethanë rënduese gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti edhe më parë ka qenë i dënuar me dënim me kusht dhe burg sipas aktgjykimeve të plotfuqishëm: P.487/2013,

dhe P.nr.863/21 në Gjykatën Themelore në Prizren. Prandaj duke pas parasysh të gjitha faktet, arsyet dhe rrethanat e përmendura më lartë, gjykata ndaj të njëjtit ka shqiptuar dënimin me burgim, duke qenë i bindur se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

### 7. Zëvendësimi i dënimit me burgim në dënim me gjobë

Gjyqtari i vetëm gjykues, duke u bazuar në nenin 44 të KPRK-së, me pëlqimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, dënimin me burgim të shqiptuara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi i ka zëvendësuar me dënim me gjobë në shumën që është shqiptuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke i marr për bazë rrethanat e lartcekura.

### 8. Vendimi për realizimin e kërkesës pasurore-juridike

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest të rregullt juridiko - civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 462 par.2 të KPP-së.

### 9. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 lidhur me nenin 453 par. 1 të KPP-së, ndërsa për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 36 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 364 të KPP-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i përgjithshëm – Divizioni Penal**  
**P.nr.108/21, me datë 26.03.2024**

**Zyrtari ligjor**  
**Amar Hoxha**

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
**Arlind Sharani**

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.